



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 36, datë 09.07.2026



PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.99, DATË 28.10.2024 "PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË PIKËN 1, TË VKB-SË NR.575, DATË 20.12.2018 TË NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET VENDNDODHJEVE TË REJA TË VENDQENDRIMEVE TAKSI (4+1) DHE (8+1) NË QYTETIN E DurrësIT"

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, VKM nr.153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-së nr. 663, datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorrët me ndezje pozitive nga ana me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit" i ndryshuar, Udhëzimi nr.12, datë 19.07.2007 "Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e liçensave, blloku të udhëtimit dhe regjistrimit të shërbimit taksi" i ndryshuar, Udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999 "Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar, VKB nr. 575, datë 20.12.2018 "Për ndryshimin dhe disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.60, datë 22.12.2005 "Për miratimin e krijimit të vendndodhjeve të reja të vendqëndrimeve taksi (4+1) dhe (8+1) në qytetin e Durrësit dhe miratimin e kriterëve shtesë të operatorëve taksi, që kryejnë shërbimin taksi në transportin rrugor

të udhëtarëve”, (i ndryshuar me VKB nr.164, datë 23.12.2021; VKB nr.13, datë 06.02.2024 si dhe me VKB nr. 99, datë 28.10.2024), si dhe sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Planifikimit të Transportit Publik dhe Licensave në Drejtorinë e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :




1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 28.10.2024 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në pikën 1, të VKB së nr.575, datë 20.12.2018 të ndryshuar, përsa i përket vendndodhjeve të reja të vendqëndrimeve taksi (4+1) dhe (8+1) në qytetin e Durrësit”, sipas planvendosjeve bashkëlidhur, si më poshtë vijon:
 - a. Miratimin e 5 posteve shtesë parkimi taksi në vendqëndrimin ekzistues, pranë Lokal ‘Tivari’, Lagjia nr.1, Taulantia, sipas Genplanit bashkëlidhur vendimit.
 - b. Miratimin e 8 posteve parkimi taksi, në Rrugën “Adria”, Lagjia nr.12, pranë Pallatit të Sportit “Ramazan Njala” sipas Genplanit bashkëlidhur vendimit.
 - c. Miratimin e 5 posteve parkimi taksi, Lagjia nr.13, Rruga Pavarsia, pranë shkollës 9 - vjecare “Bajrami Curri” sipas Genplanit bashkëlidhur vendimit.
 - d. Miratimin e 4 posteve parkimi taksi, Lagjia nr.13, Rruga Pavarsia, pranë zonës “Iliria” sipas Genplanit bashkëlidhur vendimit.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik në Bashkinë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE
Denisa Luarasi

U shpall sot me datë 10.07.2026

GEN-PLANI Pozicioni i taksive : pranë Lokal "Tivari", Lagjia nr.1, Taulanfia - 8 poste parkimi taksi.



BASHKIA DURRËS



MIRAT Q
KRYETARI BASHKIA
Enxhona SAKO

DIREKTORIA E PROJEKTEVE,
INFRASTRUKTURES PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT PUBLIK

Dejtar
Alda Zyberi

SEKTORI I PLANIFIKIMIT I ETRA SPORIT
PUBLIK DHE LUCENCAVE
Specialiteti:
IMI Polodhi
Mirroza Dymishit
Ylliona Boriq



GEN-PLANI Pozicioni i taksive : pranë "Pallati i Sportit Ramazan Njalla", Lagjia nr.12, Rr. Adria - 8 poste parkimi taksi.



BASHKIA DURRËS




MIRALOTI
KRYETARI BASHKISE
Emiliano SAKO
DREJTORIA E PROJEKTEVE
INFRASTRUKTURES PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT PUBLIK
Drejtori
Aida Zyleri

SEKTORI I PLANIFIKIMIT TE TRASPORTIT
PUBLIK DHE LUCENCAVE

Specialistët:
Ivi Palodhi
Mimoza Dymish
Vijana Boraj



GEN-PLANI Pozicioni i taksive : pranë "Shkollë 9-vjecare Bajram Curri", Lagjia nr.13, Rr. Pavaresia - 5 poste parkimi taksi.



BASHKIA DURRËS



MIRATOI
KRYETARI BASHKISË
ENTHUSIASTO

[Signature]

DREJTORIA E PROJEKTEVE,
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT PUBLIK

Drejtori
Alida Zyren

[Signature]

SEKTORI I PLANIFIKIMIT TRASHKIMTAR
PUBLIK DHE LUCENCA VE

Specialist:
Ivi Poladri
Mirhoxha Dymir
Yllona Boraj

[Signature]



GEN-PLANI Pozicioni i takside : pranë zones "Iliria" , Logjia nr.13, Rr. Pavaresia - 4 poste parkimi taksi.

BASHKIA Durrës




AMRTOI
KRYETARI BASHKISE
EMILIO SAKO

DREJTORIA E PROJEKTEVE,
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT PUBLIK

Drejtor
Aldi Zyfer

SEKTORI PLANIKIMI IË TRAJTORE
PUBLIK DHE TËCENCAVE
Specialistët:
Ivi Palodhi
Miriona Durrës
Yliona Baraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 537/2 prot.

Durrës, më 15 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.36 datë 09.07.2026 ,” Për miratimin e disa shtesave në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.99, datë 28.10.2024 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në pikën 1, të VKB-së nr.575, datë 20.12.2018 të ndryshuar, përsa i përket vendndodhjeve të reja të vendqëndrimeve taksi (4+1) dhe (8+1) në qytetin e Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

